



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	178/13
Nr. i fq. / Br. st	-10-
Data: / Datum	25.07.2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 27.06.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gérxhaliu, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Gani Imeri, Pajazit Pllana (me leje), anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtoret e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Debat lidhur me rendin e ditës:

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit - propozoi që të futet në "të ndryshme" Propozim-vendimi për hartimin e planit për veprim në mjesid.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së i ka propozuar kuvendit që të shqyrtojë dy çështje: shqyrtimi i marrjes së vendimit për vendosjen e ndriçimit rrëth Palestrës së Sporteve "Jeton Tërstena", si dhe shqyrtimi nga ana e kuvendit i marrjes së vendimit që të gjitha institucionet publike (arsimore dhe shëndetësore) në Komunën e Vushtrrisë ta kenë një mbishkrim me dimensione standarde dhe me logo të Republikës së Kosovës, duke shtuar se pasi që mbledhja e kaluar e KK-së ka qenë shumë e ngarkuar, por për këtë mbledhje të KK-së nuk ka marrë asnje njoftim pse këto dy çështje nuk janë në rend dite. Pastaj lidhur me punimet në rr. "Dëshmorët e Kombit", paraqiti vërejtje që askund nuk është e vendosur tabela se kur kanë filluar dhe kur pritet të përfundojnë punimet, dhe për çdo projekt të paraqitet pamja sesi do të duket objekti apo rruga, si dhe shtoi se janë

anashkaluar qytetarët në këtë pjesë të rrugës, prandaj për vërejtjet e bëra, kërkoi që të informohet nga kryetari i komunës.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- në emër të banorëve të fshatit Novolan, paraqiti kërkësën e tyre që kuvendi komunal t'ju përgjigjet pse nuk po zbatohet vendimi i kuvendit të komunës rrëth asfaltimit të rrugës Bukosh-Brusnik, pasi që pér këtë rrugë kuvendi i komunës ka marrë vendim para një viti. Po ashtu adresoi edhe një shqetësim të tyre se buxheti i komunës nuk është gjithëpërfshirës, pasi që kishin vërejtje se pjesa më e madhe e buxhetit po orientohet vetëm në disa fshatra, duke filluar prej Cecelisë, Stanocit, Dubocit, Beçiqit dhe Strocit, prandaj kërkoi që të jemi të kujdeshshëm pér këto dy çështje, pasi që tanë është fazë kur po përgatitet draft-buxheti pér vitin 2014.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se në bazë të planit vjetor të punës së kuvendit të komunës, pér muajin tetor është paraparë informata pér gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë pér periudhën janar-qershori 2013, por propozoi që kjo informatë të paraqitet në muajin korrik, duke shtuar se kohëve të fundit është paraqitur dukuria e vjedhjeve masovike të shtëpive, prandaj është e nevojshme të kemi një informatë më reale mbi gjendjen e sigurisë në të gjitha sferat.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që të shtyhet pika nr. 7 nga rendi i ditës pér mbledhjen e ardhshme të KK-së dhe e njëjtë të kompletohet, si dhe kërkësës t'i bashkëngjitet propozim-vendimi, po ashtu t'i bashkëngjitet vendimi i kryetarit pér formimin e komisionit pér emërtimin e rrugëve. Ndërsa pér pikën nr. 8 të rendit të ditës, tha se ka qenë premtim i kryetarit të komunës që lista pér shtruarjen e rrugëve me kubëza do të aprovohet në kuvend, kurse në kuvend ka ardhur si informatë, prandaj kësaj informate është dashtë t'i bashkëngjitet lista me emrat e rrugëve të cilat janë aprovuar në kuvend, dhe pér këtë arsyе kërkoi sqarim pér pikën nr. 8 të rendit të ditës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar vërejtjeve dhe pyetjeve të anëtarëve të kuvendit u përgjigj si vijon: Për propozimin e ndriçimit pérreth palestrës sportive, tha se nuk mund të futen projekte të reja pér çdo mbledhje të KK-së, dhe shtoi se kjo çështje e ngritur është një sugjerim pér Drejtoren pér Shërbime Publike. Pastaj mbështeti plotësisht propozimin e paraqitur që të gjitha institucionet publike (arsimore dhe shëndetësore) në Komunën e Vushtrrisë ta kenë një mbishkrim me dimensione standarde dhe me logo të Republikës së Kosovës. Ndërsa lidhur me punimet në rr. "Dëshmorët e Kombit", tha se është propozim i mirë që të vendoset tabela treguese pér fillimin dhe mbarimin e projektit edhe pse një gjë e tillë ekziston në kontratë. Sa i përket akuzave të paraqitura nga banorët e fshatit Novolan, tha se akuzat në fjalë nuk qëndrojnë, dhe shtoi se në mesin e fshatit Novolan është asfaltuar rruga, kurse pér çështjen e sigurisë, tha se sekretaria i drejtohet policië me një shkresë ku kërkon informatën pér gjendjen e sigurisë pér periudhën 6-mujore. Në fund tha se është lista pér të cilën është marrë vendimi në kuvendin e komunës pér rrugët që duhet të shtrohen me trotuare dhe shtoi se këto rrugë po shtrohen me prioritet, varësisht prej participimit më të madh të qytetarëve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se nuk ka kërkuar që menjëherë të realizohet projekti pér ndriçimin pérreth palestrës së sporteve, por ka kërkuar që propozimin e tij ta shqyrtojë kuvendi, dhe në rastin e parë të mundshëm t'i jepet pérparësi këtij projekti. Po ashtu tha se ka ankesa të disa qytetarëve që janë pronarë të lokaleve, se nuk ka trajtim të barabartë para ligjit, pasi që disa pronarëve që iu është dhënë leje e përkohshme pér ndërtim të katit të dytë, kurse në rastin tjetër nuk iu është dhënë leja, prandaj pyeti pse nuk ka trajtim të barabartë të qytetarëve nga ana e autoriteteve komunale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me pyetjen e B.Jasharit, tha se nuk është në dijeni pér ndonjë rast që iu është dhënë leja pér mbindërtim, sepse lejet e përkohshme nuk mund të jepen pér objektet që kanë pllakë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanim miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme buxhetore 2014/2016.
3. Shqyrtimi i Informatës për përgatitjet përfushatën e korrje-shirjeve.
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me shërbimet publike: furnizim me ujë, pastrim të mbeturinave dhe ambientit.
5. Shqyrtim i Propozim-vendimit përdryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.297/12, të Këshilli Komunal përf Siguri në Bashkësi.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit përdryshimin dhe plotësimin e vendimit të KK-së Nr.19-2/10 të Komitetit përf Komunitete.
7. Informimi i anëtarëve të KK-së lidhur me listën e rrugëve, të cilat do të shtrohen me kubëza betoni.
8. Shqyrtimi i Draft-rregullores përf Shërbime Komunale (shqyrtimi i dytë).
9. Shqyrtimi i Draft-rregullores përf Dhënien e Dekoratave (shqyrtimi i dytë).
10. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit përf hartimin e planit përf veprim në mjeshtë.
 - b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme buxhetore 2014/2016.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, tha se pikat kyçë që duhet të diskutohen brenda kësaj kornize janë: caktimi i prioriteteve strategjike zhvillimore, dhe shtoi se këto prioritete caktohen nga politikat makrofiskale dhe makroekonomike të qytetit; korniza fiskale komunale, që nënkupton se mjetet që janë në dispozicion (grantet) që përfaqësojnë buxhetin me 90 % dhe vlera e të hyrave vetanake, si indikator të zhvillimit ekonomik; donatorët e jashtëm, të cilët paraqesin fuqi në rast të paraqitjes së projekteve konkrete dhe tērheqjes së investimeve nga to; shpenzimet afatmesme komunale nënkuptojnë mënyrën sesi do të shpenzohen mjetet e mbledhura dhe grantet nga qeveria; plani i zhvillimit kapital, që paraqet shpenzimin e mjeteve të qytetarëve, dhe si do të ndikojë ky shpenzim në përmirësimin e nevojave të qytetarëve. Në vazhdim tha se në bazë të këtyre pesë pikave formohet buxheti final, i cili duhet të përcaktohet dhe mbështetet në Ligjin mbi Financat Publike. Pastaj tha se qëllimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore është identifikimi i burimeve të të hyrave dhe investimi i tyre në prioritete të caktuara përf krijimin e një ambienti më të mirë përf qytetarët dhe bizneset, prandaj realizimi i këtyre prioriteteve varet 90 % nga grantet dhe pjesa tjetër nga të hyrat vetanake, të cilat do t'i mbedhë qeveria komunale me politikat e veta. Sa i përket indikatorëve që ndikojnë në mbledhjen e këtyre të hyrave, komuna është bazuar në ekonomitë familjare dhe në biznese, dhe shtoi se në faqen nr. 3 të kësaj draft-kornize, thuhet se Komuna e Vushtrrisë ka të regjistruar 3133 biznese, dhe kjo është një anomali që të ceket në një draft-dokument, pasi që në tabelat në faqen nr. 9 të hyrat përf taksën në firmë përf vitin 2013 janë 155.000 €, e nëse kjo shumë futet në proporcion me numrin e bizneseve të regjistruara, kjo tregon se nuk është në rregull, sepse dihet që Komuna e Vushtrrisë i ka 2000 biznese aktive që paguajnë në buxhetin komunal. Mandej tha se fuqia e rritjes së të hyrave vetanake është

mbledhja e borxheve të këqija, që paraqiten në bilancin e komunës afro 2 milionë euro, si dhe rivlerësimi i pronave të ekonomive familjare dhe të bizneseve, e që do të ndikonte në rritjen e të hyrave vetanake, sidomos nga tatimi në pronë. Sa i përket grantit të përgjithshëm në nivel të arsimit për vitin 2014, shihet se është shënuar rënie për 2.66 %, përkundër asaj se dihet në çfarë gjendje është arsimi në Komunën e Vushtrrisë. Po ashtu, përkundër nevojave të mëdha për vitin 2014, granti i shëndetësisë ka një rritje shumë të vogël, prandaj kërkoi që për këto dy grante të ketë rritje të mjeteve, për të plotësuar nevojat e qytetarëve. Në fund tha se pikë kyçe e cila ndikon në Kornizën Afatmesme Buxhetore janë edhe donatorët e jashtëm, ku shihet se ka një rënie drastike të këtij pozicioni nga viti 2011 në vitin 2012, ndërsa është paraparë një rritje drastike për vitin 2013, prandaj duhet të fokusohemi në paraqitjen e projekteve konkrete, me qëllim të thithjes së investimeve nga donatorët, sepse esenca e Kornizës Afatmesme Buxhetore është trekëndëshi: priorititet, mjetet buxhetore dhe realizimi kualitativ i projekteve e që nënkupton shpenzim kualitativ buxhetor të mjeteve të qytetarëve.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, tha se ka disa zëra që ose nuk përputhen ose mund të shtohet diçka që është në interes të komunës dhe konkretisht përmendi përmirësimin e kushteve për arsim, duke propozuar që të hyjë edhe pura praktike në shkollat profesionale, sepse vetëm ia shton vlerën kësaj kornize. Po ashtu duke iu referuar faqes 2, kërkoi që disa shifra të mos dalin kontradiktore, prandaj duhet të jetë një përputhje e saktë. Mandej te faqe 6, tabela 2, lidhur me grantin për arsim, tha se arsimi ka qenë prioritet i prioritetave, dhe për këtë arsy shprehu pakënaqësinë e tij për zgjelimin e këtij granti, sepse granti për arsim gjithmonë është dashtë të jetë në rritje. Në vazhdim duke iu referuar faqes nr. 8 për të hyrat vetanake, propozoi që të hyrat vetanake të shkojnë në proporcion me mundësitë dhe të bëhet përpjekje për të pasqyruar se sa mund të realizohen ato. Në fund tha se në bazë të kësaj kornize pasqyrohet fuqia ekonomike e një komune, prandaj kërkoi angazhim maksimal në mënyrë që të bëhet një kornizë buxhetore sa më e suksesshme për vitet në vijim.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se korniza në fjalë është një dokument shumë i rëndësishëm për komunën tonë. Pastaj tha se KPF-ja në rekomandimet e veta që ia ka drejtuar kuvendit, në rekomandimin e parë kërkon që të bëhet rivlerësimi i pronave të ekonomive familjare dhe bizneseve, si dhe të identifikohen burimet financiare me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake të komunës, prandaj kërkoi të ta dijë se cila është përgjigjja dhe komenti i DBF-së lidhur me këtë rekomandim. Kurse te korniza e përgatitur e prezantuar në faqe 8, ku janë paraqitur diagramet që tregojnë për gjendjen e inkasimit të të hyrave vetanake për vitet 2010, 2011 dhe 2012, ku shihet se ka pas një ngritje të të hyrave në vitin 2011, ndërsa rënie në vitin 2012, por në tabelën tjetër janë paraparë rritje për çdo vit, prandaj shtoi se është shumë me rëndësi që së pari përgjegjësitë komunal të DBF-së të dinë saktë se cilat janë ato burime që të orientohen kah, ato për të rritur inkasimin e të hyrave vetanake për periudhat e viteve të ardhshme. Në vazhdim tha se ka raste të trajtimit jo të barabartë të bizneseve, pasi që ka biznese që nuk janë të regjistruara dhe operojnë në mënyrë ilegale, kurse të tjerat që mezi mbijetojnë, ngarkohen, prandaj kjo nuk është korrekte, ndërkaq autoritetet komunale e kanë obligim t'i përdorin të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe të mundshëm që trajtimi të jetë i barabartë, si dhe të identifikohen bizneset që operojnë në mënyrë ilegale, pasi që ka të tilla nga shumë sektorë, sepse kjo ndikon në inkasimin e të hyrave vetanake.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kornizës në fjalë, tha se ky dokument është me shumë rëndësi, por në kuptimin e përfshirjes dhe krjimit të një dokumenti të mirëfilltë, ky dokument është i mangët, duke shtuar se nuk mund t'i jepet dikujt leje që të marrë rolin e kuvendit të komunës për caktimin e projekteve kapitale për periudhën vijuese, prandaj ky dokument duhet të vijë në kuvend duke respektuar hapat e veprimit që janë të nevojshëm deri në miratimin e përgjithshëm

të kornizës në fjalë. Po ashtu tha se Komuna e Vushtrrisë në pjesën tjetër të prioriteteve strategjike shumë pak ka përpunuar çështjen e krjimit të ambientit të volitshëm për tërheqjen e investimeve, sepse duke u bazuar në shënimet e USAID-it (të bazuara në një hulumtim që është bërë në Kosovë) rreth tërheqjes së investimeve nëpër komuna, Komuna e Vushtrrisë është e radhitur e 26-ta në krahasim me komunat tjera, dhe në këtë drejtim nuk është përpunuar se çfarë lehtësira dhe çfarë ambienti do të krijojmë në tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin e komunës. Gjithashtu tha se është e nevojshme që të dihet numri i të punësuarve në sektorin privat në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj pyeti se a ka plan për inkasimin e 2 milionë eurove nga borxhet e këqija, si dhe kërkoi listën e broxlinjve më të mëdhenj, pasi që ato raste që janë probleme të rënda sociale, kuvendi i komunës mund të merr vendim që ato raste t'i lirojë, kurse rastet që kanë biznese të mëdhaja duhet ta paguajnë borxhin. Në fund tha se është obligim rivlerësimi i pronave, pasi që tek rivlerësimi i tyre ka hapërisë që të krijohen të hyra.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- tha se për përgatitjen e kornizës në fjalë merret për bazë qarkorja buxhetore, dhe pas aprovimit final, kornizës në fjalë do t'i bashkëngjitet lista me projektet prioritare 2014-2016. Pastaj tha se në rastin e pranimit të qarkores buxhetore, shihen edhe kufijtë e përcaktuar buxhetor, prandaj në suaza të qarkores buxhetore bëhet edhe planifikimi i buxhetit. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me kornizën në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se korniza në fjalë është një draft, i cili do të përpunohet gjatë muajve në vijim, dhe në fund të muajit shtator do të aprovohet, dhe për këtë kornizë edhe KPF-ja ka mbajtur disa dëgjime buxhetore në qytet dhe nëpër fshatra. Pastaj lidhur me kornizën në fjalë, tha se ekziston planifikimi nga viti i kaluar, sepse edhe në vitin e kaluar është bërë planifikimi për vitet 2013 dhe 2015, prandaj duhet të merren parasysh ato planifikime, duke i shtuar propozimet edhe për vitin 2016. Mandej tha se edhe tash, por edhe në të ardhmen baza e të hyrave vetanake ka me qenë tatimi në pronë dhe shtoi se e kemi obligim që për çdo vit të identifikohen ndërtimet e reja. Në fund përmendi vetëm disa nga investimet e jashtme shumë të rëndësishme që janë bërë në Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:

Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2014-2016 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 1/2013 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Shqyrtimi i Informatës për përgatitjet përfushatën e korrje-shirjeve.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, pasi që Ministria e Bujqësisë ka marrë vendim që në këtë vit të mos subvencionohen kombajnerët, pyeti se cili do të jetë roli i komisionit të formuar për ndihmën e bujqve në korrje-shirje, nëse nuk mund të ndikohet në çmimin sipas kushteve që i ofrohet kombajnerëve si në vitin e kaluar, dhe në vitet tjera kur janë subvencionuar me derivate të naftës, prandaj shprehu shqetësimin se po stimulohen vetëm të fortit (të mëdhenjtë).

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, paraqiti vërejtje për përbërjen e komisionit, duke shtuar se në komision është dashtë të ketë ekspertë të fushës përkatëse. Kurse sa i përket benefacionit përfundit, tha se 25 %-shi është shumë i vogël, prandaj propozoi që të rritet kjo përqindje. Mandej tha se është dashtë të kemi një informatë lidhur me zonat se cilat prej tyre janë mbjellur me grurë, si dhe të kontrollohen kombajnerët, në mënyrë që të dihet se cilët prej 58 kombajnerëve i plotësojnë kushtet përfundit.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- tha se ata që kanë mbjellur mbi 2 hektarë, kanë pasur subvencionime nga ministria, por ka raste kur i kanë mbjellur 70 -80 ari, dhe nuk kanë subvencionime e që ka raste që nuk kanë mjete as për ta korrur, prandaj pyeti se si t'ju ndihmohet dhe çfarë bën komuna për bujqësi.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, pyeti se a ka të dhëna se cilat sipërfaqe kanë qenë të mbjellura me grurë, elb dhe tërshërë në vitin e kaluar, dhe a ka shtim të sipërfaqeve me të mbjellura në këtë vit, apo ka zvogëlim të të mbjellurave me këto tri kultura në krahasim me vitin paraprak, duke pyetur se a ka pasur ndonjë sipërfaqe të mbjellur edhe me thekër. Pastaj ngriti çështjen e dëmeve që për shkaqe natyrore mund t'i kenë pësuar bujqit që kanë mbjellë këto tri kultura, prandaj pyeti se a ka menduar drejtoria komunale në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë për t'i kompensuar ata që kanë pësuar dëme, pasi që kjo do të shkonte në favor të stimulimit të Sektorit të bujqësisë.

Tefik Maloku, zyrtar në DEBPZHR- tha se Drejtoria e Bujqësisë është informuar në këtë vit nga Ministria e Bujqësisë se nuk do të subvencionohen kombajnerët me naftë, me arsyetimin se në këtë vit është rritur vlera e subvencionimit për një hektar të mbjellur me grurë. Pastaj tha se janë ndihmuar pjesa dërrmuese e fermerëve, duke i përfshirë edhe ata që kanë mbjellë 20 ari e sipër me grurë, duke bërë bashkimin e parcelave. Po ashtu tha se në këtë vit ka rritje të të mbjellurave me grurë, kurse në këtë vit ka sipërfaqe shumë të vogla të mbjellura me misër, ndërkaq kultura e thekrës ka filluar të kthehet në prodhim. Sa i përket zonave të mbjellura, tha se kryesisht sipërfaqet e mbjellura me grurë janë në sipërfaqe të varfëra. Në vazhdim tha se në dy vitet e fundit është përmirësuar dukshëm gjendja e teknike e autokombajnerëve.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar bashkimit të parcelave për prodhuesit më të imtë, kërkoi që të informohet nëse ka ndodhur një rast i subvencionimit në fshatin Bukosh duke bërë bashkimin e parcelave.

Tefik Maloku, zyrtar në DEBPZHR- tha se të gjithë ata që kanë pasur sipërfaqe të vogla dhe kanë kërkuar subvencionim në Drejtorenë për Bujqësi, janë sugjeruar që të bëjnë bashkimin e parcelave, në mënyrë që t'ju mundësohet subvencionimi. Kurse sa i përket dëmeve në bujqësi, në vitin e kaluar janë ndihmuar fermerët të cilët kanë pas dëme nga të reshurat e mëdha të borës, ku kanë qenë 11 raste të tilla.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me shërbimet publike: furnizim me ujë, pastrim të mbeturinave dhe ambientit.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë është profesionale dhe gjithëpërfshirese dhe e punuar me të gjitha detajet e nevojshme, por analiza e kësaj informate nuk e ndryshon gjendjen. Pastaj tha se janë shqetësuese disa të dhëna të paraqitura në informatë, sepse nëse 540 litra ujë në sekondë në kohën e caktuar përfurnizim të qytetit të Vushtrrisë prej Shipolit nisen për Vushtrri, kurse në rezervuar arrijnë 180 litra në sekondë, atëherë 2/3 e ujit të dedikuar përfurnizim të qytetit të Vushtrrisë humb rrugës, duke i përjashtuar humbjet teknike prej 35 %, dhe shtoi se sikur të ishin eliminuar vetëm humbjet teknike, Vushtrria do të kishte ujë edhe 180 litra në sekondë më shumë. Prandaj konstatoi se fabrika nuk është duke e menaxhuar mirë ujin, sepse sikur ta kishte brengë furnizimin e mirë, ekzisojnë mundësitë për t'i eliminuar humbjet teknike, për të menaxhuar ujin më mirë, duke vendosur ujëmatës për çdo kyçje, dhe në këtë mënyrë kuptohet se sa shpenzon një fshat, duke pyetur se a është e logjikshme që një fshat me 2000 apo 3000 banorë me pas ujë sa një lagje e qytetit me 7000 apo 8000 banorë. Po ashtu tha se edhe kur të ndërtohet fabrika e re e ujit, me këtë mentalitet, prapë do të ketë probleme me furnizimin me ujë. Ndërsa sa i përket pastërtisë së qytetit, tha se përkundër masave që po ndërmerr, qyteti nuk është i pastër, duke shtuar se zgjedhjen e këtij problemi e sheh vetëm atëherë kur

çdo familje (amvisni) detyrohet t'i paguajë (kompanisë për menaxhimin e mbeturinave "Uniteti") borxhet mujore.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në këtë informatë nuk ceket se për cilën periudhë bëhet fjalë, prandaj do të duhej të ceket se cilës periudhë i referohet kjo infomatë. Pastaj lidhur me paragrafin e dytë të informatës, tha se ka pasur shumë çalime në këtë gjashtëmujor, duke shtuar se nuk ka pasur mirëmbajtje të mirë të rrugëve, sepse çdokund ka pluhur dhe kundërmim i plehrave, hedhjeve dhe ngordhësirave, po ashtu ka shumë raste që hedhurinat qëndrojnë jashtë kontejnerëve, prandaj këto hedhje pamundësojnë lëvizjen e lirë, për shkak të kundërmimit të rëndë që kanë këto hedhje, por pasi që shumë kontejnerë dhe hedhurina qëndrojnë jashtë vendit të duhur, po ngushtohet edhe hapësira e lëvizjes së këmbësorëve. Sa i përket obligimit të drejtorisë kompetente për mbledhjen e ujërave nga reshjet, tha se te udhëkryqi te parku (përballë shkollave të mesme) sa herë ka pasur reshje të mëdha, gjithmonë aty është mbledhur ujë dhe askush nuk është marrë me këtë problem, si dhe i njëjtë problem është te kisha dhe te rrëthrrotullimi (tek ish-kooperativa), prandaj nga kjo gjendje kuptohet se nuk është punuar në mënyrë profesionale, dhe nuk është vendosur mirë ujëmbledhësi, i cili do ta mbledhte ujin brenda kohës së duhur. Në vazhdim tha se në shumë raste në këtë informatë janë përsëritur pjesë nga informata paraprake, por neve si anëtarë të kuvendit na intereson se cili ka qenë përmirësimi i këtyre shërbimeve për periudhën raportuese në krahasim me të kaluarën.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë tha se uji dhe mbeturinat janë dy problemet më të mëdha, me të cilat po ballafaqohet qyteti i Vushtrrisë me vite të tëra. Në këtë informatë nuk përmendet se kush merret me problemin e gjendjes së kontejnerëve. Pastaj tha se është aprovuar Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit, por pyeti se ku është Drejtoria për Inspektore, pasi që shumë qytetarë hedhin mbeturina me thasë jashtë kontejnerëve. Po ashtu kërkoi që të hiqet kontejneri, i cili është i vendosur para portës së dytë të Akademisë Policore, gjithashtu përmendi edhe disa raste tjera ku janë të vendosur kontejnerët në qytet, dhe kërkoi që të njëjtit të hiqen. Në fund paraqiti problemin e shtyllës elektrike në qendër, i cili është duke u rrëzuar, dhe nga i njëjti janë të rrezikuar fëmijët.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me përbajtjen e paragrafit të faqes nr. 2 të informatës në fjalë, ku flitet për përmirësimin e furnizimit me ujë, kërkoi që të riformulohet, pasi që nuk përputhen ngjarjet njëra me tjetrën.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- e përgëzoi drejtorinë përkatëse për punën që ka bërë, dhe shtoi se falë punës së mirë të qeverisë komunale janë larguar deponitë ilegale të mbeturinave dhe ato hapësira janë shndërruar në parqe. Pastaj tha se është një pjesë në dalje të Vushtrrisë, ku qytetarët e pandërgjegjshëm po i hedhin mbeturinat në një arë, prandaj kërkoi nga drejtoria që të vendoset një shenjë, që nëse qytetarët hedhin mbeturina, të njëjtit do të gjobiten.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se duhet të sqarohet se a dëshirojmë të furnizohemi me ujë nga fabrika jonë, apo nga Mitrovica, dhe shtoi se gjatë fushatës zgjedhore është premtuar se për një vit e gjysmë apo dy vite përfundon ndërtimi i fabrikës, por kanë kaluar gjashtë vite dhe nuk është kryer fabrika, prandaj qytetarëve duhet t'ju thuhet e vërteta. Mandjej lidhur me atë që është pasqyruar në informatë për njësinë organizative të kompanisë së ujësjellësit regional "Mitrovica", tha se me asnjë mjet themelor nuk është furnizuar kjo ndërmarrje nga vitet 1999-2000, prandaj duhet të ndërmerret diçka, ose të ndahet buxhet apo përmes donacioneve, si dhe është e domosdoshme zgjedhja e statusit të ndërmarrjeve komunale, pasi që kompetencat janë të përziera. Në fund tha se duhet të jetë kërkesë e kuvendit që këto çështje të zgjidhen, në mënyrë që të krijojen parakushte për shërbime më të mira për qytetarë, për ambient më të mirë, për ujë më të mirë dhe për gjelbërim më të mirë.

Naile Osmani, anëtar e kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të PDK-së përkrahu informatën në fjalë, duke shtuar se informata është profesionale, dhe ka të dhëna të mjaftueshme. Pastaj tha se Grupi kuvendar i PDK-së kërkon nga Drejtoria për Inspektim që të zbatojë Rregulloren për përdorimin e ujit dhe mirëmbajtjen e ambientit.

Sami Istrefi, drejtor i DSHP-së- lidhur me vërjetet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit për informatën në fjalë, tha se deri në vitin e kaluar gjendja e pastërtisë së rrugëve nuk ka qenë e mirë, për shkak se ka qenë një buxhet i kufizuar, ku ka qenë e mundur vetëm një herë në muaj të ketë larje-fshirje, por tani që është lidhur kontrata kornizë dyvjeçare me kompaninë, ku do të ketë tri herë në muaj larje, pesë herë fshirje, dhe tri fshirje në periferi të qytetit. Po ashtu tha se në aksionin e fundit me tri autofshisa është bërë thithja e pluhrale në qytet. Kurse për çështjen e mbledhjeve të ujërave, tha se në tri segmentet është duke u punuar, ku pritet të ketë edhe riasfaltim në njërin segment në mënyrë që të mundësohet rënia e ujit atmosferik, kurse në dy segmentet tjera janë duke u zhvilluar punime. Sa i përket çështjes së hedhurinave, tha se në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë identifikuar dy deponi ilegale të hedhurinave, por nevojitet zbatimi i të gjitha akteve të nxjerra nga kuvendi i komunës, si dhe zbatimi i ligjeve përkatëse të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me shqetësimet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit për informatën në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se çështjen që e ngriti lidhur me problemet në kryerjen e punëve, siç është rasti në rrugën kryesore, ku edhe uji po mblidhet e për të cilin problem drejtori tha se do të prehet asfalti te kooperativa, shtoi se problemi këtu qëndron pasi që asfalti po prehet për ta bërë mirë (për të pas rënie të ujit) me paratë e taksapaguesve. Kurse për çështjen e hudhjes së mbeturinave, tha se Drejtoria për Shërbime Publike duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë për Inspektim, si dhe të dy këto drejtori me Policinë e Kosovës për të parandaluar hedhjen e mbeturinave dhe për të gjabitur ata që hedhin mbeturinave.

Në vazhdim janë diskutuar së bashku këto pika të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.297/12, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
6. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KK-së nr.19-2/10 të Komitetit për Komunitete.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- pyeti kryetarin e komunës lidhur me emërimin e komandantit të ri në Stacionin e Policisë në Vushtrri, se a e kanë marrë mendimin e kryetarit, ashtu siç parashihet me ligj për emërimin e komandantit në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se komandanti është emëruar nga nivelet më të larta të strukturave të policisë dhe ministrisë. Po ashtu tha se prej që është emërtuar komandant, ekziston një bashkëpunim shumë i mirë me të.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar faqes nr. 2 të arsyetimit të propozim-vendimit, paraqiti një korrigjim të përmbytjes së fjalisë, si dhe shtoi se do të duhej që propozim-vendimit t'i bashkëngjitet edhe procesverbali i përmendur në këtë arsyetim.

Në fund të diskutimit lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01Nr.297/12, dt. 30.10.2012, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1., nënpika 2, në vend të Abdulaziz Hoxhës, duhet të jetë Bashkim

Spahiu – Komandant i Stacionit Policor në Vushtrri, si dhe nënpika 8, në vend të Ferki Eminit, duhet të jetë Imer (Tafil) Shaqiri- përfaqësues i komunitetit rom.

Me vendimin (tjetër) ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01Nr.19-2/10, dt. 28.01.2010, për formimin e Komitetit për Komunitete, si vijon: në paragrin 1, pika 7, në vend të Ferki Eminit, duhet të jetë Aziz Emini, përfaqësues i komunitetit rom.

7. Informimi i anëtarëve të KK-së lidhur me listën e rrugëve të cilat do të shtrohen me kubëza betoni.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se rruga "Luan Haradinaj" është rrugë në lagjen e ashkalive, dhe e njëta nuk është e rregulluar, por as nuk është në plan të rregullohet, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që t'i jepet përparësi, pasi që është rrugë ku banon një komunitet pakicë. Po ashtu kërkoi që të rregullohet edhe rruga "Faik Konica".

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur me listën në fjalë dhe shtoi se përparësi po iu jepet shtrimit të rrugëve për të cilat ka participim më të madh nga banorët, ashtu siç ka marrë vendim edhe kuvendi i komunës. Në fund tha se do të shikohen mundësítë për dhënien e përparësisë për rregullimin e këtyre dy rrugëve të propozuara nga B.Jashari.

Shpëtim Zhegrovë, anëtar i kuvendit- duke iu referuar listës në fjalë, tha se e njëjtë listë është aprovuar më herët në kuvendin e komunës. Po ashtu tha se është vendimi i kuvendit të komunës që iu jep përparësi shtrimit të atyre rrugëve, për të cilat komuniteti participon më shumë. Kurse për shtrimin e rrugës së mulla-Feratit, kërkoi që kuvendi të merr vendim për ta liruar nga participimi, dhe e njëjtë të jetë prioritet për t'u shtruar këtë vit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- e përkrahu propozimin e Shpëtim Zhegrovës për lirimin nga participimi për shtrimin e rrugës së mulla-Feratit.

8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Shërbime Komunale (shqyrtimi i dytë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit në mënyrë unanime u vendos me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Shërbime Komunale.

9. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave (shqyrtimi i dytë).

Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës së KK-së.

10. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e planit për veprim në mjedis.

Idriz Ismajli, drejtor i DUMIM-së- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pas votimit në mënyrë unanime u vendos me sa vijon:

Me këtë vendim merret iniciativa për hartimin e Planit për Veprim në Mjedis në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2013-2018, i cili do të jetë në përpjekje me planin e Republikës së Kosovës për Mbrotje të Mjedisit.

Kryetari i komunës autorizohet që të formoj grupin punues për hartimin e Planit për Veprim në Mjedis, në të cilin përveç zyrtarëve të komunës, do të përfshihen edhe përfaqësues nga ndërmarrjet për kryerje të shërbimeve publike, përfaqësues të OJQ-ve dhe të komunitetit të biznesit.

Kryetari i komunës autorizohet që të nënshkruaj marrëveshjen e mirëkuptimit me Qendrën Rajonale për Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC), si implementues të planit për veprim në mjedis, si dhe projektit i cili do të identifikohet për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Vushtrrisë.

b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- kërkoi nga kryetari i komunës që të shpejtohet kryerja e punimeve në rrugët që janë më të frekuentueshme, pasi që është sezona e ardhjes së shumë bashkatdhetarëve nga bota e jashtme. Pastaj pyeti drejtorin e DKRS-së se a është planifikuar ndonjë aktivitet për të rinjët që vijnë nga diaspora.

Gjylsime Feka, anëtar e kuvendit- duke iu referuar shtyrjes së Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave për mbedhjen tjetër të KK-së, tha se kjo shtyrje nënkupton se drejtori i DKRS-së nuk i merr punët seriozisht, pasi që i neglizon, si dhe është mospërfillës, duke e lidhur këtë edhe me Ditën e Çlirimt të Vushtrrisë, kur ai ka bërë një gabim dhe ka kërkuar falje, por kërkim faljen e tij nuk ka dashur ta kupton si një tallje të tij, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që një gjë e tillë të mos ndodh në herët tjera. Gjithashtu kërkoi që një drejtor i emëruar nga kryetari i komunës të mos bëjë tallje dhe mospërfillje ndaj përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve, posaçërisht ndaj përfaqësueseve femra, duke shtuar se i njëjti drejtor ka shkelur nenin 7.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe 12 ligjet e miratuara (dhe 3 në draftim) për barazi gjinore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në fund tha se është ndier shumë keq dhe e fyer në Ditën e Çlirimt të Vushtrrisë lidhur me përgatitjen dhe nivelin e programit që është paraqitur në skenë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se për dy pyetje ka marrë përgjigje, kurse për dy pyetje tjera nuk ka marrë përgjigje, prandaj kërkoi përsëri përgjigje lidhur me çështjen se si është privatizuar shtëpia e mallrave. Po ashtu kërkoi që të mos vijnë përgjigje gjysmake, pasi që profesorët i kanë marrë të paratë (kompensimin) për provimet private, por nuk i kanë marrë të gjitha paratë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05.

Procesmbajtësi



Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa